

V E N D I M
Nr. 194, datë 9.5.2002

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË MINISTRAVE TË UKRAINËS PËR HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për heqjen e vizave për pasaportat diplomatike dhe të shërbimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË MINISTRAVE TË UKRAINËS PËR HEQJEN E VIZAVE NGA PASAPORTAT DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Kabineti i Ministrave të Ukrainës dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë (më poshtë referuar si Palët,

Duke dëshiruar të lehtësojnë, në mënyrë të ndërsjellë, hyrjen, daljen dhe lëvizjen e qytetarëve të tyre.

Kanë rënë dakort sa më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e Shtetit të secilës Palë, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, kanë të drejtë të hyjnë, dalin dhe të kalojnë tranzit nëpër territorin e Shtetit të Palës tjetër pa viza.

Me mbërritjen atyre u garantohet e drejta të qëndrojnë në territorin e Shtetit të Palës tjetër, për një periudhë deri nëntëdhjetë (90) ditë.

Neni 2

Anëtarët e përfaqësive diplomatike ose misionëve konsullorë dhe organizatave ndërkombëtare, të akredituar në territoret e Shteteve Palë kanë të drejtë të hyjnë, dalin ose qëndrojnë në territoret e Shteteve Palë pa viza gjatë gjithë periudhës së akreditimit. Kjo klauzolë, gjithashtu, zbatohet për anëtarët e familjeve të diplomatëve dhe përfaqësuesve konsullorë, që janë mbajtës së pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.

Neni 3

Hyrja dhe dalja e shtetasve të dy vendeve, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit në territorin e Palës tjetër duhet të kryhet në pikat e kontrollit për lëvizjen e pasagjerëve të huaj.

Neni 4

Kjo Marrëveshje nuk i përjashton shtetasit e Shteteve të secilës Palë, që janë mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, nga detyrimi për të respektuar ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e Shtetit pritës.

Në anën tjetër, kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtën e të dy Palëve të refuzojnë hyrjen ose të ndalojnë qëndrimin e shtetasve të Palës tjetër në territorin e vet, nëse ata kryejnë akte që shkelin legjislacionin e shtetit pritës.

Neni 5

Palët do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike specimenet e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit tridhjetë (30) ditë përpara se kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi.

Palët do të informojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike për hyrjen në qarkullim të pasaportave të reja, ose ndryshimet në dokumentet e vlefshme dhe do të shkëmbejnë specimenet e këtyre pasaportave, përpara gjashtëdhjetë (60) ditëve nga fillimi i përdorimit të pasaportave të reja ose ndryshimet në pasaporta.

Neni 6

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet dhe shtohet me marrëveshje ndërmjet Palëve. Ajo formalizohet me protokolle të veçanta, që përbëjnë pjesën thelbësore të kësaj Marrëveshje.

Neni 7

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e gjashtëdhjetë (60), pasi Palët të njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore, të nevojshme për hyrjen në fuqi të saj.

Secila Palë mund të ndërpresë vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje, pasi të ketë njoftuar për këtë Palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, Marrëveshja do të shfuqizohet nëntëdhjetë ditë pas ditës në të cilën Pala tjetër ka marrë njoftimin.

Bërë në Tiranë, më 19. 4. 2002 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, ukrainase dhe angleze.

Në rast kontradiktash për interpretimin e teksteve në gjuhët ukrainase dhe shqipe, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

Për Qeverinë e Republikës
të Shqipërisë

Për Kabinetin e Ministrave
të Ukrainës